

**VENDIM**  
**Nr.859, datë 16.12.2011**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE, PËR RRIJTJEN E PAGAVE TË PUNONJËSVE DHE SHPËRBLIMIN E PUNONJËSVE ME RASTIN E FESTAVE TË FUNDVITIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, t’i shtohet fondi prej 4 799 345 (katër milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë) lekësh, i cili të përdoret, si më poshtë vijon:

a) 2 299 345 (dy milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dyzet e pesë) lekë, për përballimin e efekteve financiare shtesë nga rritja e pagave të punonjësve të këtij institucioni;

b) 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, për shpërblimin e punonjësve të kësaj drejtorie për festat e fundvitit.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**